



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË XI TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 22.11.2016 (E Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit: Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Vjollca Kadolli - Halili, Arbresha Ibrahim, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idri, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislimaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abazi, Mirlinda Sadiku, Vehbi Rama, Majlinda Ostroglava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, përfaqësuesi i Zyrës për Integritet Evropian, mjetet e shkruara.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardh në seancën e XI të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës, z.Sokol Haliti, Nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar Këshilltar komunal, Drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara. Më lejoni të ju informoj, se Zyra Ligjore e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, na ka konfirmu ligjshmërinë e akteve, të cilët i kemi nxjerr ne si Kuvend Komunal në seancën e fundit dhe ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.

Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni.

z.Samet Idri: Përshëndetje, unë dua ti ngriti dy çështje të qytetarëve të Komunës së Vitisë, të cilat kanë të bëjnë me disa punime, që janë bë këtu në Komunën e Vitisë. Vitin e kaluar është shtrur një shtresë asfalt prej pasqyrës deri te rrethi, te xhamia që është, edhe aty kane mbet

shumë keq ato gropat e kanaleve atmosferike, kur është shtrur asfalti, u ngrit niveli e gropat kanë mbet shumë poshtë, dhe po paraqesin rrezik për makinat. Është mirë me intervenu e me u rregullu. Çështja tjetër, në vitin e kaluar në rrugën "Dëshmorët e Kombit", është bërë një kanal i ujërave atmosferike, janë vendosur gypat edhe është bërë trotuari. Trotuari shumë mirë që është bërë, por, edhe aty kur janë bërë kanalet, të cilat i tërheqin ujërat atmosferik, nuk janë bërë mirë, edhe si shkak është ngushtu rruga shumë, edhe nuk janë punu mirë. Është mirë edhe ato me i dal mi vizitu, me i pa që kanë nevojë. E di që vitin e kaluar keni intervenu me drejtorin në një pjesë aty, por, tash prapë po ka probleme. Edhe një çështje tjetër që po du me e ngrit, është trajtimi i qenve endacak, tash ka fillu koha me u ftofë, janë paraqit qenët endacak, ka ankesa sidomos në lagjen tem, nxënësit kur po shkojnë në shkollë po frikësohen. Duhet me pas naj mënyrë, që t'i trajtojmë qentë endacak.

z.Daut Xhemajli: Përshëndetje për të gjithë! Një çështje e kem ngrit diku në fillim të këtij viti, me 16 shkurt ne mbledhje të KPF-së, e ku kem kërkuar, që komuna, ekzekutivi, të merr të gjitha hapat e nevojshme për themelimin e ndërmarrjes publike komunale për ujësjellës, kanalizim, hapësira publike, transport publik, ndriçim publik etj etj, ta beje ekipin, dhe t'i drejtohet me kërkesë Qeverisë për lejimin e kësaj ndërmarrje, që është mendoj domosdoshmëri për Komunën e Vitisë, dhe e cila është konform përgjegjësi të komunave lidhur me furnizimet me ujë, kanalizim, trajtim të ujërave të zeza, mbeturinave etj etj. Mendoj që këto investime komuna qyshe është tu i bërë, ti menaxhoj vete. Unë mendoj, që ne seancën e radhës të obligoj ekzekutivin të paraqitet me një projekt edhe të arsyetojmë, të diskutojmë, të debutojmë lidhur me këtë kërkesë, që duhet t'i drejtohem Qeverisë, tu e pas parasysh, që ligjet në fuqi lejojnë këtë themelim. Çështja tjetër është, se herën e kalime u mirrem vesh, me një formë kërkuam prej ekzekutivit ta mundësoj një takim me Ministrinë e Transportit dhe me Zyrën e Kryeministrit, lidhur me kyçjen e Vitisë në autostradën që po ndërtohet në Gerlicë. Deri tash, që një muaj kjo zhegitje, unë mendoj që është e paarsyeshme, ka qenë dashur të organizohet një takim, kërkoj sqarim: Pse nuk është bërë kjo deri tash?

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë! Te Shërbimet Publike, te "Eko higjena", në shumë vende jam ka e shohë, që një javë nuk janë marr kontejnerit para dyerve që kanë mbet: pse kjo gjendje? Ne kemi caktu një herë një person, që do ta kontrollon "Eko Higjeren" prej Vitisë, pas dy muajve e kemi prurë një vendim, që e kemi shkarku at person që ka kërku qashtu, edhe ma kurrë nuk e kemi qu asnjë, e tash pse kjo po ndodh kjo gjendje e kontejnerëve, e cila është që gjashtë muaj, por, kjo java e fundit është që nuk i kanë marr hiq. Te Drejtoria e Arsimit prapë është shpall një konkurs për drejtorë, që tri herë anulohet, mirëpo e lexova te një konkurs për punëtor teknik, aty thotë kërkohet përgatitja profesionale, diploma e fakultetit, nuk besoj që ka diploma fakulteti për punëtor teknik. Te asfaltimet në qytet, mendimi im është, që këto kanë qenë një nder asfaltet më të mira në nivel të vendit, nuk kanë qenë të gjitha rrugët që kanë qenë mu shtrur, e kam përcjell, me asnjë projekt nuk jeni tu marr leje urbanistike dhe Drejtoria e Urbanizmit nuk ka qasje dhe nuk e di asnjë projekt që është tu bërë. Po me intereson, a është bërë pranimi teknik i qetyre asfalteve, çka është me e keqja, para komunës u qas asfalti, edhe u mush me zall të ri mu

mbulu ato vrime, kjo është më e keqja që e kam pa, që i kam fotografu e i kam dëshmitë krejt. Për qet pranim teknik, kisha kerku me pas kujdes, mos me na ndodhë sikur rruga e Terezës.

z.Baki Nebiu: Përshëndetje për të gjithë, unë e kam një shqetësim, ku janë bë disa ndriçime publike nëpër fshatra, por edhe në qytet, kërkoj nga drejtori i Shërbimeve Publike, a e ka ndërmend me e ndriçu stacionin e autobusëve, pasi që tash po terrohet herët dhe nxënësit aty po e kaloj kohën në terr. Është mirë me pas primare, me ndriçu at vend, pasi që është nevojë e nxënësve dhe e udhëtarëve. Sinjalizimi i vijave në qytet, para tre muajve para se me e shtru asfalt, i ki sinjalizu vijat me ngjyrë të verdhë dhe mas tre muajve është bë asfaltimi në qytet. Nuk e di sa e kemi lluksin në brenda tre muajve me e sinjalizu vijat dy herë në qytet. Banoret e fshatit Remnik, kërkojnë nga ju të dinë, se rrugët bujqësore, rruga “Cerofcit” dhe rruga për në Nasalë, kërkojnë me ditë a kanë mu asfaltu, apo mu shtru në zhavorr, pasi që të dyjat janë rrugë të pa kalueshme për banoret që i kanë arat atje.

Kryetari z.Sokol Halitit: Përshëndetje për të gjithë! Unë fillimisht për shkak se na kanë ndodhë disa aksidente fatale, një tragjedi e vërtet, ku kanë humbur jetën dy të ri, njeri nëpunës i komunës, kisha kerku, që në emër të qeveris, kuvendit, të ju shprehim familjes së tyre ngushëllime, bashkërisht, institucionalit, kuvend dhe qeveri, ndërsa këtij djali të Sodovinës, i cili është në gjendje të rëndë në spital, ti dëshirojmë shërim sa më të shpejt. Po përgjigjem në pyetjet e parashtrua nga asamblistët. Sa i përket asfaltimit prej pasqyrës deri të xhamia, është e vërtet që është një asfalt që është riparuar, dhe me të vërtet, ka nevojë. Drejtori i Shërbimeve Publike duet ta merr këtë pyetje, se është e vërtet që është ajo disnivele i asfaltit dhe i kaptazheve, që ky e ka në plan, edhe unë mendoj, që brenda jave ki me pas të rregullime, për shkak se janë tu punu me komiona, që me i nivelizu këtë, siç i kemi nivelizu rrugës për në Ramnisht, por, me të drejtë e ke ngritë, por, tash është radha, se edhe ato mi kompatibilizua me asfaltin e ri të ndërtuar edhe te rivalizuar, për shkak se ka qenë i shkatërruar, besoj që pajtoheni edhe ju. “Dëshmorët e Kombit”, trotuari edhe uji atmosferik edhe vet e njih këtë problematikë dhe edhe drejtori i Shërbimeve Publike, për shkak se kam marr pjesë. Nuk është problemi vetëm i rrugës dhe trotuarit, që është rregulluar bashkë me DEMOS-in, financuar nga këta të fundit me komunën. Është një problematikë pak ma e gjerë me ujërat atmosferik, që duhet ne me punua, për shkak, se intervenimi i tanishëm, na u ka dashtë një prerje cezarike që e kemi bërë, ju e dini shumë mirë, jemi që ujërat atmosferik që ti hekim prej asaj lagje. Unë mendoj, se është një pjesë që duhet mu rivitalizua, për ata nuk është planifiku asfalti me shtruar pa i rregulluar edhe ujërat sipërfaqësore, dhe besoj se do ti bëjmë të dyja bashkë. Trajtimi i qeneve endacak është problematikë në nivel vendi, ndoshta edhe regjioni, se e kam pa edhe ma larg, por ne duhet ta shikojmë Komunën tonë. Është e vërtetë, se importimi i qeneve apo eksportimi prej atyre që i sjellin, këtu është evident, se kam pa shumë edhe janë evidentuar edhe me foto, që po na i sjellin. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim, edhe mbrëmë kemi pasur takim për këtë çështje, është drejtori i Bujqësisë prezent, që në mënyrë sa ma profesionale me zvogëlu numrin e tyre. Te themelimi i ndërmarrjes, tash e kemi ligjin edhe duhet me shikua qe na i mundëson ligji me bë, a është nevojja, a është “Eko Higjiena” në krizë nuk kemi nevojë qe me diskutuar, se për ata e di, se e dini të gjithë, se ajo ka qenë në krizë edhe para se me ardhur, edhe ne tash si ne kemi arritur një progres me arrit me

mbulu këtë krizë. Këto 2-3 vitet e fundit është çështje se e kemi bërë me përpjekje maksimale, me shumë punë shtesë edhe me ndihmën e donatorëve, por, problematika numër një është në Gjilan, për shkak se është kompani regjionale, ndërsa aspekti tjetër, unë e kam themeluar një trupë profesionale, të cilës mundeni me ju bashkangjitur, edhe është mirë me ju bashkëngjitë, për themelimin e ndërmarrjes sa i përket “Eko Higjienës”, e cila lejohet me ligj në kuadër të ministrisë, po varet sa ministria do të ketë mirëkuptim për neve. Për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, na jemi duke bërë edhe planin mi mirëmbajtur veç e veç, sikur që e kemi pasur edhe planin e mobilitetit, edhe ky plan do të implementimet. E përmendi Bekimi, ai djali që ka dhanë dorëheqje ka qenë në shoqëri të aksionarëve, por, është edhe diçka tjetër, unë kur e kam marrë statutin, na nuk kemi pasur në statut aksione fare, ajo është problematikë tjetër, unë nuk kam dashtë me bë problem këtë punë, për shkak se ka qenë lëshim i madh i ma hershem, dhe na nuk duhet vetëm me kritiku, por, duhet edhe me i përmirësu, për ata nuk e kam bërë të madhe, është edhe drejtori këtu, ka qenë luftë ndërmjet Ne, austriakëve dhe Komunës së Gjilanit, Kamenica u riaktivizu, ajo e ka pasur të njëjtën çështje, mirëpo u kthye, na kemi bërë luftë për me i marr aksionet. Problemi tash nuk është te aksionet, problemi është te përfaqësimi në bord, se aksionari kryesor që është Gjilani ka probleme me “Eko Higjienën” dhe unë nuk kam dashtë të jem pjesë e luftës Gjilan – austriak, se vetë e kanë bërë këtë edhe aksionet i kanë marr vet. Greva dje ka përfunduar, nuk e kemi pas lehtë këto ditë, shpejtë do ta sajojmë gjendjen që është krijuar, dhe na do ta shikojmë mundësinë për krijimin e kompanisë tonë, nëse na i lejojnë. Ndërsa, të “Hidro Morava”, te ujësjellësi, tash jemi me një rrugë ku e kemi problem, edhe ligji na ndalon edhe janë partneritetet tash me zviceran për ujë dhe rivitalizim të ujësjellësve, dhe ne fazën e pestë të krijimit të “Hidro Moravës”, që kanë dhënë kompetenca edhe mundësi, që me i marr edhe në mbikëqyrje ujësjellësit ekzistues, por, edhe me kriju ujësjellës të ri dhe mi rivitalizu këto. Janë gjithsej 7 në Viti, që tri prej tyre vetëm kanë fillu një lloj procedure. Sa i përket kyqjes së Vitisë në autostradë edhe takimi me ministrin, unë me ministrin vetëm gjate javës jam taku dy herë për te mirën e Vitisë, unë prapë po ju them, formone një delegacion ju, ne mundem prapë me shku me taku ministrin, edhe të njëjtat çështje i kemi. Mirëpo, momentalisht as kryeministri nuk ka mundësi me e ndryshuar kontratën, por ne presionet e përbashkëta i vazhdojmë. Me datën 28 nëntor, është paraparë një agjendë, të cilën e ka paraparë drejtoresha për Kulturë, ku do te jemi bashkë, ku e kemi një seancë solemne. Natyrisht do t'i përurojmë edhe dy shkolla, shkollën në Beguncë dhe në SODOVINË të QERKEZËVE, do te jemi se bashku te gjithë kuvend e qeveri. Konkursi për drejtorë është i tejkaluam, ngase që njëherë u përsërit, por, është përsërit, se është dashtë me përsërit, ngase që ka munguar ana formalo-juridike. Te asfalti ne qytet, nuk ka qenë më i mirë në Kosovë, po ta them me sinqeritet të plotë, nëse i ki pa edhe anësoret e trotuareve që janë rregullu sheshi, e kane pas të tregume se deri ku duhet me shku asfalti, për me qenë kompatibil me sheshin, me trotuarin. Këto janë krejt donacione qe i kam nxjerr unë. Te sinjalistika që ishte pyetje, është e rregulluar me ligj të komunikacionit dhe shkruan, se ngjyrat e verdha tre muaj apo një muaj përpara janë të përkohshme, këto shkojnë zakonisht para riparimit, ndërsa tash pasi është rregullu janë bë të bardha sipas udhëzimeve. Te lejet urbanistike, po ju them, se bashkëpunimi ndërmjet drejtorëve është shumë i mirë, nuk e di a ka pas ndonjëherë

naj bashkëpunim me të mirë ndërmjet drejtorive, një ekip unifikues, ku kemi meritë krejt neve, edhe ne kuvend po edhe ne qeveri. Edhe leje janë duke lëshuar, kërkesa njëra drejtori tjetër është duke i bërë dhe lejet janë tu lëshu, por, janë tu bërë shumë punë në Viti. Sot po ju them, që shkollën e Pozheranit e nisim më së largu të martën, ka pas hezitime, dikush ka thanë jo, po tash po e bëjmë realitet, e besoj shumë që edhe palestrën kemi me nis shumë shpejt. Te ndriçimet publike, stacioni i autobusëve, e kemi projektin hazër, se ju e dini ne fazën e parë, në vitin 2014, e kemi hek ujin edhe lloqin, tash e kemi projektin hazër, nuk muj të bëjmë kurgja pa projekt edhe pa buxhet. Buxheti është miratu, projeksinin e kemi, projekt që do të jetë me perona, me krijim të kushteve edhe tjerat teknike, ndoshta edhe e mbulojmë prej shiut, do të jetë me ndriçim, me VC e me pjesë tjera, stacionit do ti rikthehet entuziazmi dhe zhvillimi aty. Ndriçimet në qytet janë rivitalizu në masën 80%, mundeni me i pa, shumë pak mundeni me gjet poqa jo të dhezur në mbrëmje, janë punëtorët që punoj, që i rregullojnë këto, ndërsa kemi shkatërime të këtyre. Është mirë me i lut qytetarët mos me i dëmtu. Rrugët bujqësore në fshatin Remnik, e përmende rrugën për Nasal, jemi tu e bërë një investim kapital, është historik dhe do ti shikojmë edhe ato tjerat, rrugët bujqësore janë prioritet për neve.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Kryetar për sqarimin që dhatë rreth pyetjeve të parashtruara nga ana e këshilltarëve, dhe deklaroj që në seancën e XI të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, kemi paraparë këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim për shpalljen e diskutimit publik për propozimin për ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Vitisë.**
- 3. Propozim vendim për pezullimin e përkohshëm të nenit 21 dhe nenit 13 pika 13.6 të rregullores Komonale për taksa ngarkesa dhe gjoba**
- 4. Propozim vendim për faljen e borxheve të taksës në biznes**
- 5. Propozim vendim për miratimin e rregullores për shërbimin e transportit me Merimangë për territorin e Komunës së Vitisë**
- 6. Informatë mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të komunës së Vitisë**

Para se ta miratojmë rendin e ditës, i kame dy propozime. Meqenëse në KPF, z.Bekimi e ka adresu pikën e tretë të rendit të ditës, që mos te miratohet në këtë seancë, për shkak, se bien ndesh me pikën e dytë të rendit të ditës, dhe natyrisht me konsultimin e grupit parlamentar që e kishim para se me ardh këtu në Kuvend, u dakorduam dhe e pamë, që është e arsyeshme propozimi i Bekimit, që këtë pikë të rendit të ditës ta shtymë për seancën e radhës. Dhe e kam një propozim tjetër, një propozim vendim, i cili na ka ardh për kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është një rregullore e cila është punu që një kohë të gjatë me DEMOS-in e Zvicrës, dhe pas mbledhjes së fundi të KPF-së, na ka ardh kjo dhe na kanë sugjeru, që të miratohet brenda këtij viti. Meqenëse ne e kemi edhe një seancë në muajin tjetër, parashihet që kjo rregullore të del në dëgjim publik. Unë ju kërkoj, që ta fusim këtë në rend të ditës, në mënyrë që ta merr miratimin nga ju e të del në diskutim publik, në mënyrë që në seancën e radhës ta diskutojmë. A jeni që me qeto dy propozime të cilat u dhanë, që ta miratojmë këtë rend dite, ju lutem me ngritje dore: a ka kundër?, jo, abstenime jo, d.m.th nga të gjithë të pranishmit u miratua ky rend dite.

Pika e parë

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? Pasi që nuk ka, po e qes në votim për miratim: Kush është që miratohet pika e parë e rendit të ditës: Konstatohet që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua pika e parë e rendit të ditës.

Pika e dytë

2. Propozim vendim për shpalljen e diskutimit publik për propozimin për ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba të Komunës së Vitisë

z.Ibrahim Rama: Përshëndetje për të gjithë ju të pranishëm! Kam qenë i konsultuar vazhdimisht me të gjithë drejtorit që kanë të bëjnë me këto taksa, ngarkesa dhe gjoba tjera, që janë të parapara me ligje. Ne i kemi implementu në këtë rregullore dhe i kemi paraqit sot para juve për të gjitha drejtoritë që kanë të bëjnë me taksa, ngarkesa dhe gjoba. Drejtoret përkatës janë prezent, materialin e keni pranuar me kohë për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë të rendit të ditës.

znj,Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Grupi i këshilltarëve të LDK-së është pro asaj që të vendoset për shpalljen në diskutim publik të këtij propozimi të rregullores, ndërsa personalisht kam disa vërejtje me shumë në terminologjinë. Në faqen 4, te Drejtoria për Arsim thotë: "lirohen nga pagesat nënat e vehja, që janë marrëdhënie pune". Ky ka qenë një propozim, që unë e kam bërë vitin e kaluar, kur ka qenë në diskutim kjo rregullore. Kërkesa ime ka qenë, nënat vete ushqyese, që mendoj që është terminologji shumë më normale, të neni 9.5 në të njëjtën faqe thotë, që nga taksat lirohen personat me aftësi të veçanta, edhe këtu është problematika te terminologjia, këtu duhet të jetë ose me nevoja të veçanta, që është ma profesionale ose të jetë me aftësi të kufizuara. Edhe kam një propozim, duke u bazuar në konsultim edhe me Zyrën Ligjore, në faqe 6, regjistrimi i pronës. Qeveria është duke marr masa afirmative për regjistrim të pronës të përbashkët për bashkëpronësi, edhe është liruar me një kohë të caktuar. Kërkesa ime është duke u bazuar gjithmonë në ligj, me atë çka kemi mundësi na ta ndryshojnë, t'i lirojmë nga pagesa të paktën për një vit, për vitin 2017, regjistrimi i bashkëpronësisë, këtu është vlera 20 euro. Ma merr mendja, se do të jetë si masë afirmative, që kanë interes, që pronat të regjistrohen në bashkëpronësi, është propozim, nuk di sa ka arsyeshmeri, është mirë me u konsultu edhe me Zyrën Ligjore, por, propozimi im është që të lirohen nga pagesat.

z.Nuredin Lutfiu: Lidhur me propozimin për rregulloren për taksat, ngarkesa dhe gjoba, neni 6, nga pagesat e shërbimeve komunale lirohen shfrytëzuesit e ndihmës sociale, të cilët kanë me kërkesë të Zyrës për Mirëqenie Sociale dhe të Zyrës së Kryetarit, invalidët e luftës, familjet e dëshmoreve, veteranet e luftës dhe familjet e tyre të ngushta, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e luftës, familjet e tyre të ngushta dhe komiteti rom, ashkali dhe egjiptian. Unë propozoj, që nga pagesat për shërbime të kryera komunale, të lirohen të gjithë personat mbi moshën 65 vjeçare.

z.Samet Idrizi: Edhe grupi i PDK-së e përkrahë propozim vendimin për shpalljen në diskutim publik për ndryshimet e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, duke përfshi edhe ndryshimin që është paraparë edhe për arsimin plotësues, që e keni diskutuar në KPF. Tash personalisht nuk di sa do të mund të kam qasje, a do të mund të jem prezent gjatë diskutimit që bëhet për këtë ndryshim rregullore, është mirë që unë kthehem në të kaluarën mbrapa 10 vite, ndoshta e kam

parë atëherë, se për nivelin e zhvillimit të vendit ka qenë një ngarkesë pak e madhe, edhe e paacceptueshme për bizneset. Kjo po vërehet edhe në pikën tjetër, ku parashihen tash me u fal borxhet, se shumica e qytetareve i kanë ikur asaj ngarkese. Kur bëhen tarifat e reja, është mirë të bëhet një konsultë e mirë me bizneset dhe të ngarkohen aq sa ata mund me bajt atë barrë.

z.Ali Bajrami: Isha lidh te neni 9, Drejtoria Arsimit që e kam cek edhe në KPF, se pika 9.5 nga neni 9, për pagesë, lirohen fëmijët e dëshmorëve, mbas 17 viteve fëmijë të dëshmorëve, tash unë vetëm po e potencoj, a duhet të jetë apo jo; të invalidëve, të veteranëve është diçka tjetër, a të dëshmorëve nuk di a ka vend apo jo. Edhe diçka te Drejtoria e Shëndetësisë, faqe 18, neni 24, pika 5, medikamente nga lista esenciale ofruar në barnatoren publike, paguhet 30 cent, barnat nga lista esenciale jepen pa pagesë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka, kjo rregullore do të shkoj në diskutim publik edhe kemi mundësi edhe njëherë me debat në Kuvend.

z.Basri Aliu: Është një udhëzim administrativ, që e rregullon këtë çështje. Sigurisht kjo hynë edhe në kuadër të participimit të marrjes së shërbimeve, prandaj ndryshime nuk mund të bëhen në këtë drejtim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor, unë po e qes në votim, që të shkoj për debat publik, Konstatoj se me vota unanime u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim vendim për faljen e borxheve të taksës në biznes

Drejtoria përkatëse na i ka sjell këtë propozim, në mënyrë që na ta diskutojmë. Unë po ja jap fjalën drejtorit.

z.Ibrahim Rama: Të nderuar këshilltar komunal! Taksa për biznes, që është e paraparë me rregulloren mbi taksat, ngarkesat dhe gjobat, e dini ju, se qe 5 vite është pezulluar ngarkesa e të gjitha bizneseve në këtë taksë, mirëpo ajo pjesa e taksës që ka qenë e painkasuar deri në vitin 2013, është trashëguar edhe deri me sot, dhe kjo shumë kap vlerën diku 314 mijë euro. Mos të ju marr ma shumë kohë, materialin e keni para vete, për ndonjë sqarim jam këtu për të ju ndihmuar.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush?

z.Samet Idrizi: Unë përçolla këtë listë, dhe i pash disa firma shumë të forta, me ju fal atyre borxh, ndoshta u kanë mirë me debatua për këtë çështje, se pash do firma shumë profitabile, u kanë mirë me ja pezullua, mos me u ngut me ja fal.

z.Daut Xhemajli: Tu pas parasysh që këto borxhe janë fill pas lufte e deri 2012, edhe se sipas nenit 4, drejtor, kërkoj në aspektin teknik të përmirësohemi. Thotë, e kemi një vendim të datës 09.06.2011, i cili vendim, cilën periudhë e përfshinë, se në fund të këtij neni kemi thanë, borxhet janë prej periudhës 2000 – 2012, ndërsa lista e bizneseve e borxheve që falen thotë është 01.2000 deri 01.02.2013, d.m.th duhet ta definojmë saktësisht në përputhje me atë vendimin që ka qenë ne vitin 2011, periudhën sa falen borxhet. Sa i përket faljes së borxheve, unë jam pro, duke pasur parasysh, se nuk është krejt faji te personat juridik, apo firmat, që nuk i kanë kryer obligimet, se ne kemi pasur mekanizma, kemi mund me i detyrua mu kanë ma konkret, ma korrekt, ma kompetent etj etj, faji është i joni, se ato kanë mbetur të institucioneve, e kam fjalën na si Kuvend nuk mund të marrim masa, na vetëm mundemi me kërkuar nga drejtoria, se tash e tutje me u angazhua drejtoria, me pas një databazë të shënimeve, që nuk mund me u ndërhy nga jashtë, nga cilido person, edhe me pas një databazë të besueshme edhe për ata se paguajnë, por, edhe për neve që merremi me ta.

z.Bislum Bislumi: Përshëndetje! Unë mendoj, se ky fenomen i këtyre borxheve të grumbulluara, ka rraj të fella, të pa eliminuara ato burimet edhe arsyjet pse këto borxhe janë bë. Na badihava falmi borxhe, pra, e njëjta firmë ka me vazhdu me të vjetrën, unë sipas perceptimit tim, mendoj që shumica e borxheve atyre borgjlive, kanë shfrytëzua korrupsimin e zyrtarëve, të cilët nuk i kanë mbledh ato borxhe dhe kanë ardh në këtë situatë. Nuk është e arsyeshme, që ne të kërkojmë prej një fshatari, me thanë shko paguj taksa më ta bë shërbimin, kurse firmat, sidomos ato që kanë biznese të mira dhe që duhet me kontribu më së shumti për shtetin, na po i privilegjojmë, duke ja falur borxhet. Unë mendoj, që duhet me e bë një komision, e ai komision me e pa cilat firma kanë punët mirë ose borxhit të ja falim vetëm kamaten e borxhi le te paguhet.

z.Bekim Azizi: Kur të bëjmë një krahasim mese obligimeve, pagesave dhe borxhet e mbetura, shihet, se dikun rreth 50% kanë qenë që e kanë paguar veç taksat gjatë periudhave, që parashihet në plan. Nëse ja falim na një borxh IPKO-s, kur IPKO është kompania me e suksesshme në Kosovë, është problem, është shumë gjynah, mirëpo kur i krahasojmë disa biznese tjera, ndoshta një pjesë e tyre janë që e kane lëshuar krejt veprimtarinë, që nuk mujn me funksionu, megjithatë edhe unë jam me i fal këto borxhe, sepse janë të kalueme, janë të hershme, mirëpo duhet te kemi kujdes në të ardhmen, bizneset duhet të kenë obligime.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? me ngritje dore: Konstatoj që me një abstenim dhe të gjithë të tjerët pro, miratohet kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të pestë, përkatësisht të katërt të rendit të ditës, u dakorduam të kemi:

5. Propozim vendim për miratimin e rregullores për shërbimin e transportit me Merimangë për territorin e Komunës së Vitisë

Fjalën ja kaloj drejtorit, që në pika të shkurta të naj elaboron këtë rregullore.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit! Duke u bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, paraqes këtë propozim vendim për miratimin e rregullores për shërbimin e transportit me merimangë për territorin e Komunës së Vitisë. Komuna jonë nuk e ka pas këtë rregullore, e cila i duhet komunës, materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje, urdhëroni, jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Samet Idrizi: Propozim vendimi për miratimin e rregullores për shërbimin e transportit me merimangë për territorin e Komunës së Vitisë. Mua me interesoj ma shumë, se si do të përzgjidhet operatori ose shërbyesi që e bënë tërheqjen e automjeteve. Sigurisht drejtori, ligjin, sa i përket kësaj rregullore, udhëzimit për këtë çështje e dinë ma mirë se unë, se e ka përgatitur këtë dokument. Unë e pash aty një automjet tërhiqet dhe rrinë aty ma shumë se 6 muaj, mund të shitet në ankand. Është mirë me i vërtetua këto, se a ka të drejtë pas 6 muajve komuna me shitë atë edhe sa i përket përzgjedhjes së operatorit, neni 4 thotë: “do të caktohet përmes Zyrës së Prokurimit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik”; neni 4.2, kontrata nga paragrafi paraprak lidhet për kohë të pacaktuar, deri në një vit, me mundësi vazhdimi. Sipas Ligjit të Prokurimit duhet me përcaktua, shembull e lidh ose 12 muaj ose 24 muaj ose 36 muaj, nuk mundemi 1+1 me shkua kështu, që të keni kujdes. Dhe tjetra, te neni 10, tarifa e shpenzimeve, pasi ka mundësi me pas tarifë të shpenzimeve, që e përcakton çmimin e tërheqjes, p.sh.: brenda qytetit, 15 euro një distancë, 30, tani 50 euro për një kilometër. Tash kjo mund me ra ndesh me Ligjin e Prokurimit, se Ligji i Prokurimit zhvillon procedura, ku konkurrenca është e hapur edhe nuk ka çmime të caktuara. Mund me u kanë çmimi i planifikuar deri në një masë, po i përcaktuar jo. D.m.th, neni 10 me nenin ku ju e keni përcaktuar, duhet të keni kujdes. Te neni 6 përfshihet edhe auto parku,

duhet ta ketë operatori ekonomik është mirë ta ketë një autopark të rrethuar mirë, që mos të na dalin probleme masanej, tjetër nuk kam.

z.Baki Nebiu: Sa i përket kësaj rregullore, unë kam thanë edhe në KPF atë ditë, që te neni 3, pika 3.6, ndërmarrja biznese e licencuar nga komuna për zhvendosjen e automjeteve, duhet ti ketë edhe pajisjet për bllokimin e automjeteve. Mendoj që kjo pikë duhet të jetë në nenin 6, pasi që e obligon kontraktuesin të obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit. Tjetra, e kam than edhe në komitet, është fjala për marimangë. Unë mendoj, që ne si institucion duhet ta ndryshojmë këtë fjalë, pasi kjo fjalë nuk hynë në fjalorin tonë. Është mirë me gjet një fjalë tjetër, sa keni mund me punuar në këtë drejtim nuk e di, besoj se drejtori përgjigjet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Rreth terminologjisë, unë mendoj, se kishte qenë mirë që të konsultohet lektori, se na e kemi përvetësua si term merimangë.

z.Daut Xhemajli: Kështu ne KPF kemi diktuar, po materialet nuk i keni ndryshuar, besoj se drejtori i merr shënimet, ato që janë vërejtjet të arsyeshme, e kam fjalën dhe këtë rregullore kur ta miratojmë e miratojmë me vërejtje dhe propozimet që miratohen, se p.sh.: unë po propozoj, se tërheqja mos të jetë 100 euro, por 60 euro. Nëse propozoj kështu, kryesuesi duhet me qit për me votuar, se përndryshe i bjen, unë qa kam fol është kot problemi, është se çështjet qa janë teknike, ndoshta nuk ka nevojë me u votuar. Te neni 3, unë mendoj, se tërheqja- bartja bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e policisë, të inspektorit komunal të komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të ju lëshohet urdhëresave. Unë propozoj, që këtu të shënohet nën kontrollin e policisë ose të inspektorit komunal, se na një inspektor e kemi, sa parkingje kemi, sa tërheqja mund me u kanë në komunën e Vitisë çdo kund inspektori nuk ka nevojë me qenë. Përbërja e komisionit, neni 3, pika 4, duhet të rregullohet, se e formon komuna dhe kush e formon këtë komision, edhe cila është përbërja. Një çështje tjetër, që unë mendoj se duhet me qenë të definuara të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak. Duhet me caktu paragrafin, ku cili eventualisht do të bëhen përmes bankës si të hyra të komunës. Kjo nënkupton, që komuna ka me shpall tender me ato kushtet që janë të parashikuara, duhet me i plotësua kompania fituese. Por, komuna ka me zgjedh operatorin që afron përqindje ma të vogël për tërheqjen e tyre, d.m.th në këtë aspekt na duhet me theksuar diku në këtë rregullore, kriteret që ka me u shpall ai tender nga ana e komunës, sepse personi që e banë pagesën ka punë vetëm me një person me komunën, fletë pagesën e lëshon inspektori apo policia, e paguan në adresë të komunës, personi që e bënë deliktin nuk ka punë me merimangën. Në këtë aspekt na duhet me theksua me një nen, që kur ta shpall komuna tenderin me ofruar përqindje e konkurruesve që ofrojnë këtë shërbim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Po besoj se drejtori i ka shënuar këto që u than nga anëtarët e Kuvendit.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Sa i përket pyetjeve të Dautit, na me hartimin e kësaj rregullore jemi bazuar në këto tri ligje, sidomos në udhëzimin administrativ i Ministrisë së Punëve të Brendshme i precizon shumë saktë edhe kjarhtë edhe shumë edhe vlerën e transportit.

z.Bislim Bislimi: Kjo a është kompetencë e jona apo mund edhe policia?

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka tjetër për të diskutuar, e hedhi në votim për miratim këtë pikë të rendit me vërejtjet që u dhanë nga asamblistët. Konstatoj se me vota të shumicës u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

4. Informatë mbi përgatitjen për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të komunës së Vitisë

Unë po ja kaloj shkurtimisht fjalën drejtorit rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Drejtori z.Nexhmedin Jakupi: Materialin e keni marr me kohë, nuk kisha than ta lexoj, edhe në pranverë e keni sjell informatën rreth mirëmbajtjes, ndërsa kjo është informatë rreth përgatitjes për stinën e dimrit: Nëse keni ndonjë pyetje?

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm?

Si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

5. Propozim vendim për shpalljen e diskutimit publik për propozim rregulloren, kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve

Po ju informoj edhe një herë, se është një rregullore për nivel vendi, duke ja përshtatur secila komunë kushtet dhe kriteret e veta, drejtorit përkatëse, është një rregullore që është punuar mirë, keni rast me lexuar dhe me analizuar gjatë ditëve në vijim, sepse do të shkoj në diskutim publik dhe natyrisht se miratimi i një rregullore të tillë, por, megjithatë unë po ja jap fjalën nënkryetarit, meqë ka qenë në të gjitha takimet, besoj se në pika të shkurtra të na informoj.

Nenkryetari Hasan Aliu: Para jush e keni një propozim rregullore, e cila si ide ka lindur nga DEMOS-i me asociacionin e komunave, dhe kemi bashkëpunuar si me kryesuesin ashtu edhe me drejtorat që përfshihen në subvencione. Ne si ekzekutiv e kemi formuar një grup punues dhe instruksionet që na vinë edhe nga asociacioni i komunave edhe nga DEMOS-i, është që kjo rregullore duhet të aprovohet në këtë vit dhe të funksionalizohet në fillim vitin e ardhshëm. Pra, në vitin 2017.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm

znj,Vjollca Kadolli-Halili: Ne nuk e kemi lexua ende, megjithatë parimisht pasi ka me dal në diskutim publik, ne jemi pro asaj dhe vërejtjet nëse i kemi, atëherë do ti bëjmë kur të vie për miratim, nëse kemi.

Kryesuesi z.Naim Pira: Nëse nuk ka dikush për me diskutuar, unë po e qes ne votim që të shkoj për diskutim publik: Konstatoj se me vota unanime shkon për diskutim publik kjo rregullore.

Mirupafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11 e 40 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
